

DREJT DE-CENTRALIZIMIT?

NJË ANALIZË E MJEDISIT MUNDËSUES PËR DECENTRALIZIMIN NË SHQIPËRI

SHQIPËRIA KA NJË MUNGESË të theksuar të traditës së qeverisjes së decentralizuar. Përvoja qeverisëse gjatë dekadës së parë të sistemit demokratik liberal deri në vitet 2000 përbën **valën e parë të decentralizimit**. Në vitin 1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon se “qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore”.¹ Nenet 108-115 tek pjesa e gjashtë e Kreut IV të Kushtetutës përcaktojnë nivelet e autoriteteve të qeverisjes vendore, ngritjen dhe funksionimin e tyre si dhe të drejtat dhe funksionet kushtetuese. Nën këtë frymë të decentralizimit, Parlamenti i Shqipërisë ratifikoi Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore në nëntor të vitit 1999, që garanton zbatimin e standardeve evropiane në kuadrin ligjor kombëtar. Ligji Nr. 8652 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, miratuar në 31 korrik të vitit 2000, përbën ligjin organik, që udhëheq funksionimin e autoriteteve vendore të nivelit të parë dhe të dytë. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe u miratuan ligje me rëndësi të veçantë, si Ligji Nr. 8743 dt. 22.02.2001, “Për Pronat e Paluajtshme”, Ligji Nr. 8744 dt. 22.02.2001, “Për Transferimin e Pronave të Paluajtshme Shtetërore Njësive të Qeverisjes Vendore”, Ligji Nr. 9636 dt. 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”.

Vala e dytë e decentralizimit sapo ka nisur dhe lidhet ngushtësisht me rikonfigurimin territorial të vendit sipas reformës administrative-territoriale. Pavarësisht se në programin elektoral të qeverisë parashikohej një rrugë e njëkohshme midis reformës administrative-territoriale dhe reformës së decentralizimit, realisht u ndoq një qasje sekueniale ku përpos riorganizimit territorial po përvijohet me decentralizimin.

Ky dokument analizon prirjet e përgjithshme të mjedisit në të cilin po zhvillohet aktualisht decentralizimi politik, administrativ dhe financiar në Shqipëri. Argumentet paraqiten nën dritën e valës

së dytë të decentralizimit, specifikiht hartimit të Strategjisë Ndër-Sektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2014-2020 dhe rishikimit të ligjeve kryesore me ndikim në qeverisjen vendore. Në pjesën e fundit jepen disa rekomandime për përmirësimin e mjedisit sipas parimit të subsidiaritetit dhe autonomisë vendore.

DECENTRALIZIMI POLITIK

SIPAS SCHNEIDER,² decentralizimi politik i referohet masës dhe nivelit që qeveria qendrore lejon njësitë vendore të qeverisjes të ndërmarrin funksione politike të qeverisjes. Përmbledhtazi, dimensionin politik i decentralizimit përfshin përfaqësimin që realizohet nëpërmjet sistemit të zgjedhjeve, pjesëmarrjen qytetare në proceset vendimmarrëse, cilësinë e kuadrin ligjor dhe qartësinë e ndarjes së funksioneve dhe kompetencave dhe marrëdhënieve midis qeverisjes qendrore dhe vendore.

Përfaqësimi realizohet nëpërmjet sistemit të zgjedhjeve, i cili duhet të plotësojë pesë parimet bazë të trashëgimisë zgjedhore evropiane që janë votimi i përgjithshëm, i barabartë, i lirë, i fshehtë dhe i drejtpërdrejtë. Në vijim jepen disa gjetje për përfaqësimin gjinor, përfaqësimin në këshill të qarikut si dhe disa gjetje nga monitorimi i zgjedhjeve të fundit vendore. Së pari, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë përcakton se në zgjedhjet e qeverisjes vendore të paktën tridhjetë për qind dhe një në tre emrat e parë të listës shumëemërore duhet t’i përkasë secilës gjini. Prej zgjedhjeve vendore të vitit 2011, sipas të dhënave të marra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,³ rezultoi se nga 6146 këshilltarë fitues për këshillat e komunave dhe bashkive (përfshirë 11 minibashkitë e Tiranës), vetëm 12.3% ishin gra fituese, në 88 njësi të qeverisjes vendore nuk kishte asnjë grua fituese dhe në vetëm 17 njësi gratë dolën fituese në kuotën mbi 30%. Lista e kandidatëve për kryetar komune/

1 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 13 http://www.parlament.al/web/pub/kushtetuta_perditesuar_15171_1.pdf

2 Schneider, A, Conceptualisation and Measurement of Decentralisation, *Studies in Comparative International Development*, Fall 2003, Vol. 38, No. 3, pp. 32-56.

3 http://www.cec.org.al/images/stories/zgjedhje-vendore/2011/html_lshumemerore/110919_-_DTI_-_lista_keshill_2011.htm

bashkie (përfshirë minibashkitë e Tiranës) përfshiu 872 kandidatë nga të cilët 14 ose 1.6 % ishin gra. Kjo listë prodhoi 384 fitues, prej të cilëve vetëm 6 ose 1.6 % ishin gra fituese. Në këtë mënyrë, përfaqësimi gjinor në organet e zgjedhura të qeverisjes vendore është shumë larg përfaqësimit të barabartë gjinor në vendimmarrjen politike dhe publike parashikuar nga ligji "Për Barazinë Gjinore në Shoqëri" dhe angazhimit të Shqipërisë si shtet anëtar i Këshillit të Evropës në kuadër të Objektivit 4 të Strategjisë së Barazisë Gjinore 2014-2017.

Së dyti, nenet 49 dhe 50 të Ligjit Nr. 8652, dt. 31.07.2000 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore" rregullojnë përfaqësimin e komunave dhe bashkive në këshillat e qarkut në bazë të kriterit të popullsisë. Evidentohet në bazë të të dhënave të INSTAT-it (Censusi 2011) se 77,075 banorë të bashkisë Shkodër përfaqësohen në Këshill të Qarkut Shkodër me 6 këshilltarë, ndërkohë 77,832 banorë të 27 njësive të tjera përfaqësohen me 43 këshilltarë. E njëjta situatë vihet re dhe në Këshillin e Qarkut Durrës ku 113,249 banorë të bashkisë Durrës përfaqësohen në Këshill të Qarkut me 8 këshilltarë, ndërkohë 112,929 banorë të 14 njësive të tjera përfaqësohen me 34 këshilltarë. Në të gjithë këshillat e tjera të qarqeve vihet re e njëjta dukuri. Kjo lloj procedure e shpërndarjes së mandateve shkakton **pabarazi në përfaqësim** dhe cenon një nga pesë parimet bazë të trashëgimisë elektorale evropiane që është votimi i barabartë në të cilën, sipas Komisionit të Venecias, përfshihet fuqia e barabartë e votës.⁴ Është e domosdoshme rishikimi i procedurës së zgjedhjes së këshillit të qarkut për të siguruar një përfaqësim të drejtë.

Së treti, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it në raportin përfundimtar⁵ mbi vëzhgimin e zgjedhjeve vendore të 8 maj 2011 ka evidentuar disa elementë që cenojnë përfaqësimin në vendimmarrje, të tilla si (i) në kodin zgjedhor nuk ekzistojnë dispozita të veçanta mbi zbatueshmërinë e pragjeve për shpërndarjen e vendeve në këshillat vendore, (ii) në ligjin "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore" nuk parashikohet numri i anëtarëve të këshillave që do të zgjidhen në qytetet me mbi 200 mijë banorë. Me sistemin e ri administrativo-territorial do të kemi disa bashki me mbi 200 mijë banorë. Nevojitet përcaktimi i pragut minimal për përfaqësimin

4 Kodi i praktikës së mirë në çështjet zgjedhore hartuar nga grupi i eksperteve të Komisionit të Venecias dhe miratuar nga (i) Këshilli për Zgjedhje Demokratike më 16 tetor 2002 (ii) Komisioni i Venecias më 18-19 tetor 2002 (iii) Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës në sesionin e saj të parë të vitit 2003 (iiii) Kongresi i Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Evropës në sesionin e tij të pranverës 2003

5 Raporti Përfundimtar i Misionit të OSBE/ODIHR për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Vendore, botuar më 15 gusht 2011

në këshillat vendore dhe përcaktimi i numrit të anëtarëve të këshillave që do të zgjidhen në bashkitë me mbi 200 mijë banorë.

Pavarësisht se Ligji Nr. 8652 siguron mbështetje për **pjesëmarrjen qytetare**, kjo e fundit kufizohet në informim dhe konsultim, pa siguruar mekanizma për pjesëmarrje aktive dhe të vazhdueshme të qytetarëve në vendimmarrje. Edhe pse sipas kuadrit aktual ligjor, në Nenin 35/1 të ligjit organik përcaktohen rastet kur seancat dëgjimore janë të detyrueshme, nuk sigurohet mbështetje për pjesëmarrjen qytetare aktive duke qenë se nuk ka dispozita të qarta ligjore që rregullojnë pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje në periudhën jashtë zgjedhore për (i) planifikimin me pjesëmarrje, (ii) buxhetimin me pjesëmarrje, (iii) përzgjedhjen dhe vendosjen e përparësive, (iv) trajtimin e nismave qytetare, (v) ndërtimin e politikave vendore, dhe (vi) pjesëmarrje në monitorim dhe vlerësim. Për më tepër, nevoja e rregullimit dhe koordinimit të pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrjen vendore bëhet më domethënëse në kushtet e riorganizimit territorial, ku nevojitet të përcaktohet qartë roli i strukturës drejtuese komunitare.

Procesi i konsultimit dhe marrëdhënieve ndër-institucionale mes autoriteteve të qeverisjes qendrore dhe qeverisjes vendore nevojitet të rregullohet me dispozita ligjore. Kjo është e nevojshme duke qenë se shumë akte nënligjore që prekin qeverisjen vendore kalojnë pa një proces konsultimesh me shoqatat e të zgjedhurve vendorë dhe në kundërshtim me frymën e decentralizimit dhe autonomisë vendore. Përbën risi pozitive vizioni për ngritjen e një mekanizmi këshillues midis qeverisjes vendore dhe qendrore, por nevojitet sipas edhe rekomandimit Nr. 349 për Shqipërinë (2013) të Kongresit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Evropës "të futet një dispozitë e posaçme në Ligjin nr. 8652, me qëllim formalizimin e procesit të konsultimit të pushtetit vendor, për të siguruar konsultim në kohën e duhur e në mënyrën e përshtatshme për çështje që lidhen drejtpërsëdrejti me to".

DECENTRALIZIMI ADMINISTRATIV

NËSE I REFEROHEMI SËRISH Schneider-it (ibid), decentralizimi administrativ i referohet nivelit të autonomisë së njësive të qeverisjes vendore përkundrejt kontrollit qendror. Sipas Falletit (2005)⁶, me decentralizim administrativ do të kup-

6 Falleti, T. G. (2005). A Sequential Theory of Decentralization: Latin American Cases in Comparative Perspective. *The American Political Science Review*, 99(3), 327-346.

tojmë transferimin e administratës dhe ofrimit të shërbimeve si mirëqenia sociale, shëndetësia, strehimi, prej qeverisë qendrore drejt autoriteteve vendore.

Cilësia e kornizës ligjore që përcakton statusin e autoriteteve vendore dhe qartësinë në përcaktimin e funksioneve ndryshon në varësi të funksioneve. Përsa i përket **funksioneve të veta**, kuadri ligjor është pothuajse i plotë, por treguesit e standardeve kombëtare apo të kostove për njësi nuk janë përcaktuar ende për të gjitha shërbimet duke ndikuar kështu në përlllogaritjen e burimeve dhe shpenzimeve dhe monitorimin e tyre.

Në lidhje me **funksionet e përbashkëta**, nuk ka dispozita që të përcaktojnë qartësisht përgjegjësitë institucionale. Kjo ka sjellë paqartësi, mungesë efikasiteti, paralelizma kompetencash brenda një sistemi, si p.sh., në shërbimin social, arsim dhe problematika në bashkëpunimin ndërmjet institucioneve vendore dhe atyre të dekoncentruara. Paqartësia ligjore është bërë pengesë për zbatimin e disa kompetencave si në fushën e mjedisit, shëndetësisë, trashëgiminë kulturore, etj.⁷ Gjithashtu, **roli dhe funksionet e Këshillit të Qarkut** janë të paqarta dhe të mbivendosura me ato të prefektit dhe të disa institucioneve rajonale duke sjellë dobësimin e tyre, përshtjellim dhe konflikte institucionale.

Tregues të mjedisit pozitiv mundësues të decentralizimit lidhen me miratimin e ligjit të ri Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i cili hyn në fuqi më 1 tetor 2014. Ky ligj shënon hap përpara sepse në Seksionin III "Bashkërendimi, Këshillimi dhe Shqyrtimi Publik i Dokumenteve të Planifikimit", Neni 23 detyron këshillimin dhe takimin e hapur dhe të organizuar publik që paraprihet nga lajmërimi apo njoftimi publik. Lajmërimi dhe njoftimi publik kërkohet të afishohet në mjediset e autoritetit të planifikimit dhe në hapësira të tjera që kanë aksesueshmëri të gjerë nga publiku; lajmërimi në mediat elektronike kombëtare ose vendore si edhe botimi në gazeta të pushtetit vendor ose në dy gazetatat më të lexuara në nivel kombëtar. Duket se në këtë ligj transparenca, pjesëmarrja dhe bashkërendimi janë artikuluar më qartësisht.

Nga ana tjetër, ka tregues të mjedisit jo-mundësues të decentralizimit administrativ përmes akteve dhe vendimeve që kanë prekur parimin e decentralizimit dhe autonomisë vendore. **Së pari**, vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 932, datë

30.09.2013 "Për Unifikimin e Kompetencave të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar (INUK) në Zonat me Rëndësi Kombëtare dhe në Territor" është nxjerrë në kundërshtim me parimet decentralizimit dhe autonomisë vendore të garantuara nga Neni 13 i Kushtetutës. Sipas këtij vendimi, INUK ka të drejtë të vlerësojë veprimtarinë e strukturave vendore të planifikimit të territorit. Gjykata Kushtetuese me Vendim Nr. 25 datë 28.04.2014 e ka vlerësuar si vendim në kundërshtim me Kushtetutën dhe e ka shfuqizuar.

Së dyti, vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 1, datë 22.08.2014 "Për harmonizimin e instrumenteve të planifikimit vendor në funksion të ndarjes së re administrativo-territoriale" është në kundërshtim me parimet e decentralizimit dhe autonomisë vendore dhe ka frymë centralizuese. Planifikimi urban është funksion i veti i qeverisjes vendore dhe, për pasojë, vendimi është në kundërshtim me Nenin 10 të Ligjit Nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", duke prekur autoritetin administrativ dhe rregullator të qeverisjes vendore për funksionet e veta. Gjithashtu, ky vendim është në kundërshtim me nenet 27, 40 dhe 44 të Ligjit Nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për Planifikimin e Territorit". Procesi i hartimit, miratimit dhe zbatimit të instrumentit vendor të planifikimit si dhe dhënia e lejes zhvillimore janë atribut i qeverisjes vendore. Vendimi bie në kundërshtim me Nenin 4 të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore, duke qenë se njësisive vendore nuk iu është marrë mendim paraprak.

Së treti, veprimet e Drejtorive Arsimore Rajonale/Zyrave Arsimore (DAR/ZA) për emërimin dhe shkarkimin e drejtorëve të shkollave janë në kundërshtim me Nenin 55 të Ligjit Nr. 69/2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" si dhe në kundërshtim me udhëzimin e Ministres së Arsimit dhe Sportit, Nr. 57, datë 12.11.2013. Sipas raportit të OSBE-së,⁸ procesi i emërimit dhe shkarkimit të drejtorëve të shkollave nuk po bëhet me konkurrin të hapur nga komisioni i vlerësimit në përbërje të të cilit është një përfaqësues i njësisë së qeverisjes vendore. Mospërfshirja e NJQV-ve në këtë proces cenon autoritetin e tyre të njohur me ligj dhe bën të pamundur kërkesën e llogarisë nga ana e NJQV-ve kundrejt tyre lidhur me mangësitë e shfaqura në mirëmbajtjen e infrastrukturës arsimore.

7 OSBE (2014), Analiza e Zbatimit të Funksioneve të Përbashkëta të Pushtetit Vendor në Shqipëri, Tiranë

8 Po aty

DECENTRALIZIMI FISKAL

SIPAS FALLETIT⁹, decentralizimi fiskal i referohet autonomisë fiskale të autoriteteve vendore, p.sh., nivelit të kontrollit të autoriteteve vendore për mbledhjen e taksës dhe menaxhimin e burimeve publike. Ecuria e reformës së decentralizimit fiskal mbetet e paqartë. Qeveria është angazhuar në rishikimin e të gjithë kuadrit rregullator financiar që udhëheq veprimtarinë e qeverisjes vendore me qëllim rritjen e të ardhurave të qeverisjes vendore në buxhetin e përgjithshëm (ekualizimi vertikal), si edhe përmirësimi i shpërndarjes së burimeve financiare drejt njësive të ndryshme të qeverisjes vendore (ekualizimi horizontal).

Vizioni i decentralizimit fiskal mbetet ende jo-eksplicit. Ndryshimet kryesore ligjore me ndikim në decentralizimin fiskal do të ndodhin në një periudhë afatmesme (2015-2017). Gjithsesi, duke marrë parasysh ndryshimet kryesore në organizimin dhe strukturën e qeverisjes vendore, disa çështje nevojiten të trajtohen paraprakisht.

Në lidhje me **ekualizimin vertikal**, nevojitet që qeveria të përcaktojë një objektivi mbi përqindjen e të ardhurave të qeverisjes vendore në të ardhurat e përgjithshme publike në Shqipëri. Aktualisht, ky nivel është ndër më të ulët në rajon. Disa prej objektivave që nevojiten të përcaktohen në një periudhë afatmesme përfshijnë: Së pari, **madhësia e transfertës së pakushtëzuar** nevojitet të shprehet si përqindje e të ardhurave të përgjithshme të buxhetit; së dyti, ndryshimet në **burimet e të ardhurave të veta** vendore. Ligji Nr. 181/2013 "Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin Nr. 9632, dt. 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore" ndryshoi **taksën vendore mbi biznesin e vogël në tatim të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël**. Me miratimin e këtij ligji, këshilli bashkiak/komunal nuk ka asnjë autoritet në përcaktimin dhe administrimin e kësaj të ardhure. Në këtë mënyrë, është prekur autoriteti rregullator i qeverisjes vendore në vendosjen e nivelit të kësaj takse, autoriteti administrativ i qeverisjes vendore për vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin e kësaj të ardhure. Për më tepër, ky ligj bie në kundërshtim me nenet 4 dhe 9 të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore, duke qenë se NJQV-të nuk janë konsultuar gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të tij. Taksa mbi pasuritë e paluajtshme pritet të shndërrohet në taksë me bazë vlerën e pronës, por nuk ka të dhëna mbi ndryshimet eventuale në bar-

rën e taksës apo afate kohore të reformës. Së treti, **zbatimi i taksave të ndara**, si taksa mbi të ardhurat personale (TAP) apo tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) ndihmojnë në ekualizimin vertikal. Gjithsesi, mbledhja e këtyre taksave është e përqendruar në qytetet kryesore dhe nevojitet të diskutohet se si mund të ndahen më së miri këto taksa. E vetmja taksë e ndarë që ka ekzistuar prej disa vitesh në sistemin fiskal shqiptar është taksa e rentës minerare.¹⁰ Megjithatë, transferimi i të ardhurave nga kjo taksë në buxhetet lokale të njësive vendore përfituese nuk ka ndodhur deri më sot. Ministria e Financave u shpreh publikisht gjatë një takimi me grupet e interesit në shtator 2014 se do të niste disa ndërhyrje ligjore që do të zvogëlojnë pjesën që ligjërisht u takon njësive vendore nga kjo taksë, por që njëkohësisht do të sigurojnë derdhjen e këtyre të ardhurave edhe në buxhetet vendore.

Së fundmi, për vitin 2013 evidentohen 64 vendime të Këshillit të Ministrave për transferim të pronave kundrejt qeverisjes vendore si një burim i të ardhurave, por konstatohet se procesi i transferimit të pronave është ndërprerë.

Transferta e pakushtëzuar shërben si burimi kryesor i të ardhurave për ekualizimin horizontal për njësitë e qeverisjes vendore në Shqipëri. Formula e ekualizimit nevojitet të rishikohet sipas strukturës dhe shpërndarjes së njësive të reja të qeverisjes vendore.

REKOMANDIME

DECENTRALIZIMI POLITIK

- Nevojitet disa masa dhe ndryshime ligjore që nëpërmjet zgjedhjeve të arrihet pjesëmarrja e ballancuar e grave dhe burrave në vendimmarrjen politike të qeverisjes vendore (përfaqësimi nuk duhet të jetë poshtë 30 %);
- Rishikimi i procedurës ligjore për zgjedhjen e Këshillit të Qarkut është i nevojshëm për të siguruar një përfaqësim të drejtë;
- Përcaktim i pragut minimal për përfaqësimin në këshillat vendore dhe përcaktimi i numrit të anëtarëve të këshillave që do të zgjidhen në bashkitë me mbi 200 mijë banorë;
- Rishikimi i Ligjit Nr. 8652 dhe garantimi i pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje në periudhën jashtë zgjedhore për: (i) planifikimin me pjesëmarrje, (ii) buxhetimin me pjesëmarrje, (iii) përzgjedhjen dhe vendosjen e përparësive, (iv) trajtimin e nismave qytetare (v) ndërtimin e politikave vendore, dhe (vi) pjesëmarrje në monito-

⁹ Falleti, T. G. (2005). A Sequential Theory of Decentralization: Latin American Cases in Comparative Perspective. *The American Political Science Review*, 99(3), 327-346.

¹⁰ Ligji nr. 10304 datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë"

rim dhe vlerësim;

- Ridimensionim i misionit, rolit dhe funksioneve të strukturës drejtuese komunitare në kushtet e riorganizimit territorial të vendit.
- Formalizimi i procesit të konsultimit të qeverisjes qendrore dhe vendore në përputhje me Rekomandimin Nr. 349 për Shqipërinë të Kongresit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Evropës.

DECENTRALIZIMI ADMINISTRATIV

- Përcaktimi i standardeve kombëtare për shërbimet, që janë nën përgjegjësinë e funksioneve ekskluzive për njësitë e qeverisjes vendore;
- Ripërcaktimi i qartë i funksioneve të përbashkëta dhe rishikimi i funksioneve të nivelit të mesëm të qeverisjes për të shmangur mbivendosje institucionale me institucionin e prefektit dhe autoritetet e dekoncentruara;
- Hartimi dhe miratimi i kuadrit nënligjor për funksionet ekskluzive apo të përbashkëta të NJQV-ve në respekt të hierarkisë ligjore dhe parimit të decentralizimit dhe autonomisë vendore.

DECENTRALIZIMI FINANCIAR

- Përcaktimi i një objekti të qartë mbi përqindjen e rritjes së të ardhurave të qeverisjes vendore në raport me të ardhurat e përgjithshme publike në Shqipëri;
- Madhësia e transfertës së pakushtëzuar nevojitet të shprehet si përqindje e të ardhurave të përgjithshme të buxhetit;
- Ndryshimet në burimet e të ardhurave të veta për njësitë e qeverisjes vendore nevojiten të konsultohen paraprakisht me njësitë e qeverisjes vendore dhe shoqatat e të zgjedhurve vendorë;
- Zbatimi i taksave të ndara, si taksa mbi të ardhurat personale (TAP) apo tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) ndihmojnë në ekualizimin vertikal;
- Renta minerare kërkohet të transferohet në buxhetin e njësitë të qeverisjes vendore përkatëse në respekt të ligjit Nr. 10304 dt.15.07.2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë"
- Rishikimi i formulës së ekualizimit për transfer tën e pakushtëzuar për të lehtësuar ekualizimin horizontal.

INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) është një organizatë e pavarur jo qeveritare, themeluar në nëntor 1999 në Tiranë, Shqipëri. Ajo punon për të forcuar shoqërinë civile në Shqipëri, për monitorimin, analizimin dhe lehtësimin e proceseve Euro-Atlantike të vendit si dhe për të ndihmuar konsolidimin e qeverisjes së mirë dhe të politikëbërjes gjithëpërfshirëse në vend. IDM-ja ndërmerr objektivat e saj me anë të ekspertizës, studimeve inovative mbi politikat, analizat dhe opsionet politike që bazohen në veprim.

Zgjedhja e aktiviteteve të IDM-së për të arritur objektivat e saj strategjike përbën një përpjekje për të shkuar përtej thjesht përfundimit në kohë të projektit. Ato formojnë pjesë të një përpjekjeje të vazhdueshme për të forcuar vlerat e përbashkëta dhe ndërhyrjet efikase në të gjithë spektrin e gjerë të aktorëve politikë dhe atyre jo politikë në Shqipëri. IDM-ja është e dedikuar për zhvillimin e një të kuptuari të thellë të sfidave bashkëkohore, për të formësuar strategji të qëndrueshme reformimi dhe politika publike në fushat që përbëjnë shtyllat kryesore për zhvillimin socio-ekonomik dhe atë politik të vendit si edhe për avancimin e qasjeve rajonale me kosto efektive në mbështetje të iniciativave të bashkëpunimit intra dhe inter sektorial të aktorëve kryesorë bazuar mbi studime të qarta, vlerësime politikash dhe analiza shumëplanëshe.

Rr. Shenasi Dishnica, Nr. 37, P.O.Box: 8177, Tirana, Albania,
Tel: +355 4 240 0241 Fax: +355 4 240 0640 Email: info@idmalbania.org www.idmalbania.org

Ky botim u bë i mundur me mbështetjen e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Confederation
Embassy of Switzerland

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim apo të Qeverisë së Konfederatës Zvicerane.